



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 22. 04. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi me delegacionin e Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit të Finlandës.

Delegacioni për Punë të Jashtme i Parlamentit të Finlandës ishte në përbërje prej: z. Pertti Salolainen kryesues i grupit, z. Eero Akaan-Penttilä deputet, znj. Katri Komi deputete, znj. Elisabeth Nauclér deputete, znj. Minna Hulkkonen, këshilltare e Komisionit, z. Olli-Pekka Jalonen këshilltar i komisionit, z. Juha Ottman, drejtor në njësinë për zgjerimin e BE dhe Ballkanit Perëndimor, z. Jukka Parvinen, lieutenant kolonel, znj. Mari Eteläpää KFOR këshilltare politike, znj. Tarja Fernandez e ngarkuara me punë në Ambasadën e Finlandës në Prishtinë, z. Rasmus Hindren, Ministria e mbrojtjes dhe znj. Jehona Ademaj, zyrtare në Ambasadën e Finlandës.

Në takim nga Komisioni morën pjesë: z. Sabri Hamiti, z. Eqrem Kryeziu, z. Nexhat Daci, z. Lutfi Haziri, z. Ardian Gjini, z. Ramë Buja dhe z. Dragisha Miriq.
Munguan: z. Xhavit Haliti, z. Enis Kervan, z. Ramadan Avdiu dhe z. Ibrahim Gashi.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin të pranishëm: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Ilaz Rudaku.

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Takim me delegacionin e Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit të Finlandës.

Sabri Hamiti fillimisht prezantoi anëtarët e Komisionit, ndërsa sa i përket punës së Kuvendit gjatë këtij viti, tha se kryesisht ka qenë e përqendruar në miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve të Pakos së Ahtisaarit. Njoftoi delegacionin se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ju garanton të drejta të jashtëzakonshme komuniteteve pakicë.

Në vazhdim tha se jemi në fazën e angazhimeve për njohje sa më të mëdha, nga shtetet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Kosova tani më shumë ka nevojë për ndihmë civile dhe zhvillim ekonomik, popullsia e saj është kryesisht e re dhe papunësia është shumë e madhe.

Pertti Salolainen kryesues i delegacionit tha se jemi në Kosovë në një mision faktmbledhës, për të parë gjendjen për së afërmi. Kërkoj të informohet për fushëveprimtarinë e Komisionit për Punë të Jashtme.

Sabri Hamiti tha se punë parësore e Komisionit për Punë të Jashtme është mbikëqyrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme, tani në këtë fazë do të kemi angazhime rreth përzgjedhjes së përfaqësuesve diplomatik të Kosovës.

Lutfi Haziri tha se në Kuvendin e Kosovës kemi komisione të veçanta, varësisht nga çështjet specifike që janë objekt i fushëveprimtarisë së tyre. Sa i përket Komisionit për Punë të Jashtme është në fazën e bashkëpunimit për caktimin e ambasadorëve të Kosovës në shtetet e tjera.

Pertti Salolainen kërkoi mendimin se njohja e Kosovës nga Arabia Saudite, a do të ketë ndikim në njohjen edhe nga vendet e tjera të shteteve islamike.

Sabri Hamiti tha se shpresojmë që do të ketë njohje të reja, duke e pasur parasysh se shumë shtete kanë pritur veprimin e Arabisë Saudite si një vend me ndikim në vendet e tjera islamike.

Dragisha Miriq njoftoi delegacionin se i takon GP-Zajedno në Kuvendin e Kosovës. Në Kuvend tha se i kemi 10 vende të garantuara dhe ekzistojnë dy Grupe Parlamentare, ai i SLS dhe Zajedno. Ne na takojnë dy vende në ministri, por për fat të keq ato i janë dhënë vetëm njërit grup, ndërsa grupi tjetër Zajedno është i diskriminuar, dhe nuk merr pjesë në Qeveri. Disa herë kemi kërkuar nga Kryeministri por deri më tani nuk na është ofruar asgjë.

Sabri Hamiti tha se serbet janë të diskriminuar në aspektin pozitiv dhe kanë pushtet më shumë se që kanë përfaqësim. Në Kuvend kemi pushtetin e drejtë pozitiv - opozitë, GP-ar i z. Miriqit është i krijuar muajt e fundit dhe luan rolin e opozitës, ndërsa sa u përket pushteteve ato duhet të pjesëtohen tek komuniteti serb.

Pertti Salolainen kërkoi të informohet se sa deputetë në Kuvend e përbëjnë pozitën e sa opozitën.

Sabri Hamiti për strukturën në Kuvend tha se pozitën e përbën një shumicë solide, prej dy partive më të mëdha, një parti që i përket komunitetit serb, një parti që i përmbledh komunitetet e tjera që quhet 7+, ndërsa opozita përbëhet nga tri parti shqiptare dhe një GP-ar që nuk e përbëjnë vetëm serbët të cilës i përket edhe z. Miriqi.

Elisabeth Naucér tha se i takoj komunitetit suedez dhe vij nga një pjesë e Finlandës ku flitet gjuha suedeze. Finlanda është një shtet me të drejta të barabarta për të gjithë dhe fliten dy gjuhë. Në vazhdim tha se Finlanda e ka të njohur strukturën e Pakos së Ahtisarit dhe pyeti z. Miriq, për marrëdhëniet me Beogradin dhe anëtarët e Komisionit, se a kanë provuar për të bashkëpunuar me serbët .

Dragisa Miric tha se kam lindur në Kosovë ku jam shkolluar dhe kam jetuar me shqiptarët, kam lidhje me Serbinë, kam familjar në vendet e ndryshme të Serbisë dhe mbajë kontakte të përditshme me ata. Mendoj se duhet të vijë koha e bashkëpunimit në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Pertti Salolainen tha se ka se gjeografia nuk mund të ndërrohet, nga përvoja mendoj se herët apo vonë do të keni bashkëpunim me fqinjët e juaj dhe në këtë pjesë të Evropës, BE-ja do të luaj një rol shumë të rëndësishëm.

Nexhat Daci tha se në vendin tonë 95% e popullatës janë shqiptar dhe 5% të tjerë, dhe është sukses që popullata serbe në Kosovë kanë edukim në të gjitha nivelet.

Akademia e Shkencave e Beogradit dhe Akademia e Shkencave e Kosovës janë të gjeneratave të akademive evropiane dhe duhet punuar së bashku për qëllime akademike, që të jenë të pranuar në atë bashkëpunim si Akademi e Shkencave e Kosovës dhe Akademi e Shkencave të Serbisë. Duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë të mirëfilltë me Serbinë, këtë Kosova e ka demonstruar. Ky demonstrim konstant ka themeluar një traditë për dhjetë vite, për të dhënë 20 ulëse në Kuvend, 10 prej të cilave ju

takojnë serbëve. Sipas kësaj tradite 10 vjeçare në Kosovë të cilën tha se e përkrahë, minoritetet nuk kanë qenë opozitë, gjithmonë i janë bashkëngjitur pozitës dhe kanë poste të ministrit e zëvendësministrit që nënkuptohet se kemi progres. Po ashtu tha se Kosova është shumë e familjarizuar me mënyrën e mendimit të politikës në Finlandë, që është një edukatë ndër më të mirat në Evropë.

Ardian Gjini tha se ne kurrë nuk mund ta mohojmë rolin e rëndësishëm të Finlandës të cilin e ka luajtur në Kosovë, me prezencën e misioneve të juaja në mënyrë evolutive e gjerë tek ambasada.

Kërkoi që të ndikohet në Qeverinë e Finlandës që t'i kushtohet vëmendje situatës së paangazhuar për Kosovën lidhur me lehtësimin e vizave Shengen të BE-së. Vendet e rajonit në fqinjësi kanë lehtësi dhe janë pjesë e procesit të liberalizimit të vizave, përderisa Kosova është lënë jashtë këtij procesi që do të shkaktoj probleme serioze për një vend të ri siç jemi ne.

Eero Akaan-Penttilä kërkoi të informohet se me cilat shtete janë marrëdhëniet më të mira, si dhe për rëndësinë e BE .

Sabri Hamiti shtetet me të cilat kemi marrëdhënie më të mira në radhë të parë janë SHBA, BE, për arsye të qarta, që e kanë shpëtuar para dhjetë vitesh popullin e Kosovës nga gjenocidi, që e kanë ndihmuar të ndërtohet Kosova dhe që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Sa i përket bashkëpunimeve parlamentare kemi një intensitet më të madh bashkëpunimi me vendet e BE-së, që nga legjislatura e parë e Kuvendit të Kosovës. Kemi pasur raporte të mira sidomos me Parlamentin Francez, me Bundestagun Gjerman, me Parlamentin e Sllovenisë dhe me Dhomën Përfaqësuese të Belgjikës dhe tani ky intensitet është i shtuar pas pavarësisë së Kosovës, që ka rezultuar me krijimin e grupeve të miqësisë në mes të parlamenteve. Po ashtu kemi edhe raporte shumë intensive me vendet e rajonit natyrisht në radhë të parë me Shqipërinë, me Maqedoninë, me Malin e Zi, me Kroacinë, dhe shpresojmë që këto marrëdhënie në të ardhmen të ndërtohen edhe me Serbinë si dy shtete të pavarura.

Pertti Salolainen kërkoi të informohet se a janë bërë përpjekje për influencë në shtetet të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Sabri Hamiti me vendet e BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën ekzistojnë raporte respektive, por kjo nuk do të thotë që nuk do të provohet të ketë raporte intensive sidomos në nivel parlamentar. Po ashtu ka vende që ende nuk e kanë njohë pavarësinë e Kosovës por që i kanë pranuar pasaportat e Kosovës, që është element shumë i rëndësishëm për lëvizjen e qytetarëve.

Katri Komi tha se për një zhvillim më të mirë, nevojitet qeverisje e mirë dhe sundimi i ligjit. Po ashtu kërkoi të informohet se në cilët sektorë, Kosova do të mund të ndërtoj ekonominë si shtet i pavarur dhe a ekziston ndonjë plan për t'i përkrahur femrat në ardhmen.

Sabri Hamiti në Kuvendin e Kosovës gratë janë të përfaqësuara me 30% sipas ligjit.

Nexhat Daci ne që dhjetë vite e kemi lirinë, por nuk e kemi menaxhuar vetveten, kemi qenë nën protektorat ku shumica e buxhetit ka qenë e menaxhuar nga protektorati. Nëse jemi të suksesshëm ta menaxhojmë vendin tërësisht, ekzistojnë mundësitë që Kosova të bëhet dhe të jetë një vend normal, Ballkanik i kompletuar sepse i ka burimet më të mira njerëzore në rajon po ashtu edhe burimet natyrore. Integrimi i vendeve të rajonit është një ndihmesë e mirë për të gjithë ne, që të mund të punojmë dhe demonstrojmë kapacitetet tona dhe të participojmë në ndërtimin e një mjedisi të sigurt, dhe të mbrojtur në Ballkan dhe Evropë.

Lutfi Haziri lidhur me prioritetet e zhvillimit ekonomik të Kosovës tha se ne e kemi adoptuar strategjinë për Partneritetin Evropian në Kosovë, rreth politikave të integritimit. Në Kosovë ekziston edhe Agjencioni për Integritet Evropian dhe tani jemi në procesin e studimit të fizibilitetit. Kosova

është në procesin e privatizimit të pasurisë shoqërore. Gjithashtu ne kemi edhe burime të energjisë, ku prioritet i Qeverisë është projekti i ri Kosova e re që duhet të vendoset gjatë këtij viti, ndërsa si prioritet kryesor të politikave të privatizimit janë edhe kompanitë Posta dhe Telekomit të Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës.

Elisabeth Naclér sa i përket përkthimeve tha se në institucionet tona edhe pse jemi shtet dy gjuhë folës nuk e kemi përkthime, kërkoi të informohet se a ka përkthime simultante në seancat e Kuvendit të Kosovës.

Sabri Hamiti njoftoi se në Kuvendin e Kosovës ka përkthime simultante për gjuhët zyrtare, si në seancat plenare, në mbledhjet e komisioneve dhe në të gjitha organet e Kuvendit, ndërsa çështja përfaqësimit të femrave është çështje kulturave politike që varet nga secili shtet.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit